



**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**  
**DEKANATI**

Tel/Fax: +355 4 369 987, www.fhf.edu.al  
Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë

Nr 38 prot.

**DEKLARATË**

Pas njohjes me diskutimet e zhvilluara në të gjitha departamentet, Dekanati i FHF-së deklaron se pedagogët:

- ◆ rikonfirmojnë mbështetjen e protestës së studentëve dhe të kërkesave të tyre të ligjshme;
- ◆ dënojnë ndërhyrjen e organeve të rendit në mjediset universitare dhe dhunimin e studentëve prej tyre;
- ◆ janë kundër çdolloj ndërhyrje dhe presioni, që synon deformimin e vullnetit të lirë të studentëve;
- ◆ kërkojnë ndalimin e fushatës denigruese dhe të përbaltjes masive të trupës akademike universitare nga aktorë politikë dhe qeveritarë, që synon intimidimin e mendimit të lirë;
- ◆ propozojnë ngritjen e një strukture me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve për trajtimin dhe adresimin e problematikave që po kalojnë IAL-të publike në RSH;
- ◆ rikonfirmojnë kërkesën për rishikimin thelbësor të Ligjit të Arsimit të Lartë në RSH;
- ◆ i sigurojnë studentët për gatishmërinë e tyre në angazhimin për realizimin e objektivave të vitit akademik në vijim.

Tiranë, më 14.01.2019

